



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI QARKUT SHKODËR KRYETARI

V E N D I M

Nr. 3, Datë: 08.04.2021

“Mbi miratimin e ndryshimit të Buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2021, pas miratimit të kuotave të antarësisë të Bashkive të qarkut Shkodër.”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 08.04.2021, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi dëgjoj materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit “Mbi miratimin e ndryshimit të Buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2021 pas miratimit të kuotave të antarësisë të Bashkive të qarkut Shkodër.” bazuar nën 38 e 77 të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr.137/2020 “Per Buxhetin e Vitit 2021”, pikat 3 e 4 të nenit 21 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, VKQShkoder nr.16, datë 30.12.2020, VKB nr.63, datë 28.12.2020 të Bashkisë Shkodër, VKB nr.2, datë 12.01.2021 të Bashkisë Malësi e Madhe, VKB nr.80, datë 24.12.2020 të Bashkisë Vau Dejës, VKB nr.50, datë 23.12.2020 të Bashkisë Fushë Arrëz si dhe VKB nr. 53, datë 05.01.2021 të Bashkisë Pukë; Rregullores për Organizimin dhe Funkcionimin e këshillit të Qarkut Shkodër, konkretisht neni 12,13, dhe 15 i saj. Bazuar në Aktin Normativ Nr.03 datë: 15.03.2020 konkretisht neni 5, “për vendimarrjen e organeve kolegjiale gjatë gjendjes së infeksionit Covid-19”, si dhe bazuar në Urdhërin Nr.80 datë 17.11.2020 “për miratimin e rregullave dhe procedurave standarde të punës të harmonizuara, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19...bazuar në Urdhërin nr.633 datë 17.11.2020 “për ndalimin e grumbullimeve me më shumë se 10 persona në vende të mbyllura apo të hapura...”,

Duke marrë shkas nga situata e krijuar nga pandemia Covid-19, mbledhja e Këshillit të Qarkut Shkodër u zhvillua online nëpërmjet platformës Zoom, , pas relatimit nga zyra e drejtorisë së financës dhe buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **12 Vota Pro, 0 Vota Kunder dhe 0 Vota Abstenim.**



Në përfundim Këshilli i Qarkut Shkodër

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2021, pas miratimit të Kuotës së antarësisë, që Bashkitë e Qarkut Shkodër i financojnë Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2021, kuotë e cila është planifikuar në buxhetet respective të Bashkive.

2. Kuota e Antarësisë, që bashkitë kanë planifikuar të financojnë Qarkun Shkodër për vitin 2021 do të jetë si më poshtë;

➤ Bashkia Shkodër	shuma	1,000,000 lekë
➤ Bashkia Vau Dejës	shuma	1,600,000 lekë
➤ Bashkia Malësi e Madhe	shuma	200,000 lekë
➤ Bashkia Fushë Arrëz	shuma	100,000 leke
➤ Bashkia Pukë	shuma	40,000 leke
	Totali	2,940,000 leke

3. Të behet shtesa e planit të të Ardhurave për vitin 2021 në Buxhetin e vitit 2021, të Këshillit të Qarkut Shkodër në shumën **2,940,000 lekë**.

4. Nga shuma **2,940,000 lekë**;

Shuma 1,940,000 lekë të përdoret për investimin “Rrethimi e sistemimi I varrezave të qytetit Pukë”;

Shuma 1,000,000 lekë të përdoret për Muzeumin për ekspozimin e vlerave etnografike të Shkodrës dhe veriut të Shqipërisë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër .

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**KËSHILLI QARKUT SHKODËR
DREJTORIA E FINANCËS & BUXHETIT**

Nr.Prot: 151/1

Shkodër me 17.03.2021

RELACION

DREJTUAR : Këshillit të Qarkut Shkodër.

O B J E K T I : “Mbi miratimin e ndryshimit të Buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2021 pas miratimit të kuotave të antarësisë të Bashkive të qarkut Shkodër. ”

Këshilli i Qarkut Shkodër për vitin 2021, bazuar nën 38 e 77 të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr.137/2020“Per Buxhetin e Vitit 2021”, pikat 3 e 4 të nenit 21 të Ligjit nr. 68/2017”Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, VKQShkoder nr.16, datë 30.12.2020, VKB nr.63,datë 28.12.2020 të Bashkisë Shkodër,VKB nr.2,datë 12.01.2021 të Bashkisë Malësi e Madhe, VKB nr.80, datë 24.12.2020 të Bashkisë Vau Dejës, VKB nr.50,datë 23.12.2020 të Bashkisë Fushë Arrëz si dhe VKB nr. 53, datë 05.01.2021 të Bashkisë Pukë, propozon shtesë në planin e të ardhurave të vitit 2021, për financimin nga Kuota e Antarësisë që Bashkitë e qarkut Shkodër kanë planifikuar në buxhete e tyre per vitin 2021, për Këshillin e Qarkut Shkodër.

Sipas pikës 3 të nenit 38 të ligjit nr.139/2015”Për vetëqeverisjen vendore” i cili shprehet se “Qarku financohet nga kuotat e antarësisë së bashkive përbërese e cila përcaktohet në buxhet e tyre dhe që miratohet me Vendim të këshillit të Bashkisë, paraqesim para jush për miratim shtesën e planit të të ardhurave për vitin 2021 dhe përkatsisht;

➤ Bashkia Shkodër	shuma	1,000,000 lekë
➤ Bashkia Vau Dejës	shuma	1,600,000 lekë
➤ Bashkia Malësi e Madhe	shuma	200,000 lekë
➤ Bashkia Fushë Arrëz	shuma	100,000 leke
➤ Bashkia Pukë	shuma	40,000 leke
	Totali	2,940,000 leke



Këto të ardhura, do të jenë pjesë e buxhetit të vitit 2021 dhe propozojme të përdoren për;

- Shuma 1,940,000 lekë të përdoret për investimin “Rrethimi e sistemimi I varrezave të qytetit Pukë”;
- Shuma 1,000,000 lekë të përdoret për Muzeumin për ekspozimin e vlerave etnografike të Shkodrës dhe veriut të Shqipërisë.

Nëpunësi Zbatues

Gjyljana MIRUKU

